



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1592/10 prot

Datë 31.07.2026

V E N D I M

Nr. 913/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 850/2026, datë 23.06.2026 për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “*Loti I: Blerje goma*”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

Ankimues: Operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK me NUIS K79631501Q dhe adresë: Rruga Fushe-Tepelene, Zone Kadastrale Nr.3574, Nr.Pasurie 8/22, Tepelene

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: Rruga “5 Maji” , Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin
dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 23.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 850/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “Loti I: Blerje goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tirane.*
2. *Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik “Gajd Company” SHPK në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gajd Company” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.575/18 prot., datë 03.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1592/7 prot., datë 07.07.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 850/2026, datë 23.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1.Me shkresën nr.575/18 prot., datë 03.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1592/7 prot., datë 07.07.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 850/2026, datë 23.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 850/2026, datë 23.06.2026 të KPP-së. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 850/2026, datë 23.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-77570-02-26-2026, me objekt: “Loti I: Blerje goma”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu